

ÇKA ËSHTE PAQJA?

Foto:

Nenci Axhram (nga interneti)

Citati do të shtohet

Nënshkrimi do të shtohet

Lënda: Shkenca Shoqërore; Edukim Qytetar; Edukim Personal, Shoqëror, Shëndetësor dhe Ekonomik

Mosha: 8-11 vjeç

Koha: 60 minuta

Qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm:

- Qëllimi 11 – Qytete dhe bashkësi të qëndrueshme
- Qëllimi 16 – Paqe dhe drejtësi

Objektivat mësimore:

- Të hulumtohen disa definicione të paqes
- Të hulumtohen dhe të njihen karakteristikat, veprimet dhe simbolet e aktivistëve paqësor
- Të fillohet të përcaktohen mënyrat e inkorporimit të paqes në ambientet e klasave dhe në botën për rreth

Përgatitja për mësim:

Lexo

- Gjeni fotografi të situatave paqësore dhe jo paqësore
- Përkujdesuni që nxënësit të kenë qasje në libra dhe ueb faqe për mbështetje të hulumtimit të tyre në lidhje me aktivistët paqësorë, ose shtypni informacionet nga Shtojca.

Vërejtje:

- Ky mësim hap disa çështje të ndjeshme, andaj arsimtarët duhet të jenë të vëmendshëm me përvojat dhe nevojat e nxënësve të tyre. Shih Shtojca 1

HYRJE NË PËRMBAJTJE

| Koha | Aktivitetet mësimore | Diferencimi/Aktivitetet alternative |
|------|----------------------|-------------------------------------|
|------|----------------------|-------------------------------------|

| | | |
|----------|--|--|
| 5 minuta | <p>Gjeni disa fotografi, të cilat demonstrojnë imazhe të situatave paqësore dhe jopaqësore, p.sh. lutje, miq, persona që bërtasin ose janë agresiv, tubimi të mëdha paqësore, përleshje me policinë në protestë. Imazhet do të duhet të zgjedhen me ndjeshmëri.</p> <p>Tregoni fotografitë nxënësve dhe kërkoni nga ata të shkruajnë 1-3 fjalë, të cilat mendojnë se e përshkruajnë secilën fotografi e pastaj pyetni të diskutojnë me një partner se si secila fotografi i bën të ndjehen e pastaj ndani idetë e tyre me klasën.</p> <p>Potenconi nxënësve fjalët e ndryshme për përshkrim të situatave paqësore në raport me situatat jo paqësore dhe pyetni – Pse mendoni se ka ndodh situata jo paqësore ose konfliktuozë?</p> <p>Prezantoni temën dhe qëllimet e mësimit.</p> | |
| 10 min | <p>Çka është paqja? Kërkoni nga nxënësit të zgjedhin se cili nga këta definicione mendojë se është më i saktë, ose më së shumti identifikohen me të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “të qenit i çliruar nga problemet ose brengat” • “ndjenja e qetësisë mendore ose emocionale” • “kohën kur nuk ka luftë ose lufta ka përfunduar” <p>Si e përshkruajnë nxënësit paqen?</p> <p>Përdorni pyetjet nxitëse të dhëna në vijim, që t’iu ndihmoni nxënësve t’i zhvillojnë idetë e tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A mund paqja të ketë domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm? Pse mund të jetë ashtu? • Si përballemi me konflikte? Cilat janë disa nga mënyrat paqësore për t’u përballë me konfliktin? • A e ndjejmë paqen brenda ose jashtë neve? Ose ndoshta edhe në brendinë tonë edhe jashtë në botën që na rrethon? <p>Lejoni nxënësve që për disa minuta të mendojnë në heshtje, para se t’i pyetni për përgjigjet. Shkruani në dërrasë ose në flip çart tabelë disa fjalë kyçe dhe ide të përgjigjeve të nxënësve.</p> | <p>Nëse këtë mësim ua mësoni fëmijëve të moshës 11 vjeçare ose nxënësve më të talentuar, atëherë mund ta ndani këtë deklaratë të marrë nga Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut: <i>“Njohja e dinjitetit dhe të drejtave të barabarta për gjithë njerëzimin është bazament i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.”</i></p> <p>Kërkoni nga nxënësit të mendojnë për këtë dhe të diskutojnë se çka nënkupton kjo deklaratë.</p> <p>Ky diskutim mund të ndërlidhet me aktivitetin vijues të aktivistëve të paqes: të gjitha profilet e aktivistëve të dhënë në <i>Shtojcën 2</i> iu referohen të drejtave të njeriut.</p> |

Lexoni këtë shkrim të shkurtër në internet, që të gjeni më shumë informacione për përkufizimin e paqes: <http://www.international-alert.org/what-peace>. Më poshtë është dhënë një rezymë e materialit për ata, që nuk kanë qasje në internet. (Shtojca 2)

MËSIMI I PËRMBAJTJES

| Koha | Aktivitetet mësimore | Diferencimi/Aktivitetet alternative |
|--------|--|---|
| 20 min | <p>Hulumtim për aktivistët e paqes</p> <p>Ndani nxënësit në grupe të vogla me nga tre ose katër. Nxënësit le t'i vizatojnë emrat e aktivistëve të paqes nga një qese, ose ndajani secilit grup nga një aktivist. Ndër aktivistët në fjalë janë Karim Uasfi, Lejma Gbovi, Mahatma Gandhi, Malala Jusafzai dhe Nelson Mandela.</p> <p>Mendoni në lidhje parimin e grupimit të nxënësve.</p> <p>Ndani materialet në shtojcën 3 ose pyetni nxënësit të bëjnë hulumtim më shumë për aktivistët e tyre, duke i përdorë lidhjet e internetit (linkat) në shtojcën 4. Disa nxënës mund të preferojnë materiale të shtypura, ose libra në vend se të lexojnë nga ekrani i kompjuterit.</p> <p>Përfshini cilindo tjetër aktivist të paqes, për të cilin/cilën konsideroni se mund të jetë relevant/e (shih shtojcën 4), por keni kujdes se në disa kontekste nacionale ose lokale disa aktivistë mund të konsiderohen si figura politike, andaj përzgjedhja e tyre duhet të bëhet me më shumë kujdes.</p> <p>Jepuni nxënësve një fletë të pastër, ose një pllakë për afishe (poster) dhe disa materiale për shkrim. Le të krijojnë ata afishe me fakte të rëndësishme në lidhje me aktivistët e tyre dhe për çka janë angazhuar ata. Lejoni nxënësit t'i shtypin ose t'i vizatojnë figurat e aktivistëve të tyre.</p> <p>Udhëzoni nxënësit t'i kërkojnë këta veçori specifike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cili është aktivisti yt paqësor? Si quhen ata/ato? Nga janë ata? • Cili është/ishte qëllimi i tyre? • Si arritën ose u orvatën ta arrijnë qëllimin e tyre? | <p>Për disa nxënës hulumtime për më shumë aktivistë të paqes mund të jetë i vështirë, si alternativë mund të fokusohen në një ose dy aktivistë dhe t'i studiojnë ata së bashku me klasën.</p> |

| | | |
|--------|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Pse janë paqësore metodat e tyre? • Cilat janë/ishin karakteristikat e tyre? | |
| 10 min | <p>Prezantimi</p> <p>Lejoni secilit grup nga 1-2 minuta, t'i ndajnë me të tjerët afishet dhe atë që e kanë mësuar me klasën. Në vend së t'i lexojnë drejtpërsëdrejti nga afishet, inkurajoni nxënësit të paraqesin mënyra kreative për demonstrim të diturisë së tyre (p.sh. një skeç i shkurtër) në lidhje me besimet dhe veprimet e aktivistëve të tyre. Përkujtoni nxënësve të jenë të kujdesshëm që ta shmangin përdorimin e stereotipave në prezantimet e tyre.</p> <p>Pasi të prezantojë secili grup diskutoni se çka ka pasur të përbashkët prezantimi. Cilat karakteristika, veçori dhe cilësi posedon secili aktivist? A dëshironi t'i posedoni disa nga tiparet e pacifistëve tuaj? Nëse po, cilat dhe për çfarë arsye?</p> | |

| Koha | Aktivitete mësimore | Diferencimi/Aktivitetet alternative |
|--------|---|---|
| 10 min | <p>Përkufizimet e nxënësve për paqen</p> <p>Dorëzohani secilit nxënës nga një fishë (kartelë shënimesh), ku do t'i shënojnë përkufizimet e tyre rreth paqes. Mundësojuni nxënësve ta vizatojnë vizionin e tyre për paqen, nëse nuk mund ta definojnë si tekst.</p> <p>Grumbulloni shënimet e secilit nxënës (nxënësit nuk kanë nevojë t'i shënojnë emrat e tyre nëse nuk dëshirojnë), ndërsa përcaktoni disa nxënës t'i lexojnë me zë ose t'ia paraqesin klasës.</p> <p>Orvatuni të përzgjedhni kartela me shënime, të cilat i paraqesin përkufizimet në mënyra të ndryshme.</p> | <p>Për nxënësit më të rinj dhe me më pak përvojë do të mund të përgatitni një përzgjedhje të fotografive, fjalëve dhe frazave, të cilat i inkorporojnë në definicion. P.sh. Paqja është.... kur secili është i lumtur, kur njerëzit nuk luftojnë.</p> <p>Kartelat me shënime mund të përdoren për të krijuar një imazh klase. Nxënësit do të mund po ashtu të gjejnë citate, imazhe, ose poema tjera, të cilat e përshkruajnë paqen ose rëndësinë e paqes. Ajo mund të jetë detyrë shtëpie.</p> <p>Ajo po ashtu iu mundëson nxënësve tjerë dhe vizitorëve tjerë në klasë, që të shohin se çfarë përmbajtje është diskutuar.</p> |
| 5 min | <p>Diskutimi në klasë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çka kemi mësuar sot, që mund ta ndryshojë mënyrën sesi sillemi në klasë dhe me | Si alternativë kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë përgjigjet e tyre në këta pyetje, për të kontrolluar nëse |

| | | |
|--|--|--|
| | <p>miqtë tanë?</p> <ul style="list-style-type: none">• Si mund të kontribuojmë në krijimin e botës më paqësore? <p>Le të diskutojnë nxënësit në fillim me një partner e pastaj thirrni disa nxënës t'i shkëmbejnë prezantimet e tyre më të tjerët. Theksoni sesi nxënësit mund ta bëjnë dallimin në ndihmën që bota të jetë vend më paqësor.</p> <p>Shih Shtojcën 5 për aktivitete shtesë.</p> | <p>të gjithë i kanë kuptuar disa nga konceptet e këtij mësimi.</p> |
|--|--|--|

Formulari *Thirrje për veprim*

Shtojca 1

Diskutimi me nxënësit tuaj në këtë mësim duhet ta trajtoni me ndjeshmëri dhe me konsideratë ndaj sfondit dhe përvojave të nxënësve. Ju dëshironi ta bëni klasën vend të sigurt për nxënësit, që t'i shkëmbejnë idetë dhe përvojat e tyre. Disa nxënës mund të dëshirojnë të jenë të përjashtuar nga disa diskutime dhe kjo gjë duhet të respektohet. Burimet e dhëna në vijim mund të jenë të dobishme (ndonëse mund ta ndryshoni dhe shtojcën), për mënyrën e qasjes së temave kontroverse në klasë.

- Manuali i Oksfamt, Mbretëria e Bashkuar për të mësuar çështje kundërthënëse - https://www.oxfam.org.uk/~media/Files/Education/Teacher%20Support/Free%20Guides/teaching_controversial_issues.ashx
- Manuali i Asociacionit të historisë për Mësim të historisë emocionale dhe kundërthënëse - <http://globaldimension.org.uk/resources/item/1522>
- Shumë arsimtarë vlerësojnë se teknikat e *Filozofisë për fëmijë* janë të dobishme gjatë trajtimit të diskutimeve të kësaj natyre, po ashtu mund të lexoni më shumë në <http://globaldimension.org.uk/news/item/13650>

Shtojca 2

Çka është paqja?

Ekzistojnë shumë mënyra të ndryshme për ta përshkruar paqen. Nga këndvështrimi global, paqja është momenti kur konflikti mund të zgjidhet pa dhunë dhe me atë veprim e përmirëson cilësinë e jetës.

Sipas www.international-alert.org,

“Paqja është kur:

- secili jeton në siguri, pa frikë ose kërcënim nga dhuna, ku asnjë formë e dhunës nuk tolerohet as në ligj as në praktikë
- secili është i barabartë para ligjit, sistemi i drejtësisë është i besueshëm, ndërsa ligjet e drejta dhe efektive i mbrojnë të drejtat e njeriut
- secili ka mundësi të merr pjesë në formësimin e vendimeve, ndërsa qeveria është e përgjegjshme ndaj njerëzve
- secili posedon qasje të drejtë dhe të barabartë në nevoja themelore për mirëqenien e tyre – siç është ushqimi, uji i pijshëm, strehimi, arsimit, kujdesi shëndetësor dhe mjedisi i denjë jetësor
- secili posedon mundësi të barabartë për punë dhe jetesë, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike ose aspektet tjera të identitetit.”

Pyetje për mendime kritike:

1. Pse është e rëndësishme paqja për ne?
2. Si do të dukej bota pa paqe? A do të dukej njësoj ose ndryshe?
3. Çka nënkupton paqja për ju?
4. Çka është e ngjashme ndërmjet idesë së përfshirë në këtë definicion të paqes dhe të drejtave të njeriut, për të cilat ke dëgjuar?

Aktivistët e paqes – Karim Uasfi (Karim Wasfi)



KUSH ËSHTË KARIM UASFI?

Dirigjentin i famshëm nga Orkestri i Simfonisë Kombëtare të Irakut ka performuar me violimçelo në vendin e ngjarjes ku kishte makinë bombë, si akt i mbrojtjes dhe apelit për humanizëm si për terroristët po ashtu edhe për civilët. Ai e themloi iniciativën *Përmes paqes*.

ÇKA KA BËRË KARIM UASFI?

Karimi është paraqitur në vendin e eksplodimeve nëpër Bagdad. Vetëm disa orë pas sulmeve ai është ulur në hi dhe rrënoja me kostumin e tij të zi, me flokët e gjata të krehura pas kokë dhe ka performuar me violimçelon e tij. Për të formë e rezistencës është bërë ky kombinim i muzikës dhe vendit të ngjarjes.

"Pavarësisht se çka mendojnë njerëzit, ne e kemi mundësinë për të kundërshtuar", deklaroi Uasfi. "Ne nuk mund vetëm t'i dorëzohemi fatkeqësisë duke mos funksionuar. Unë mendoj se ky është një rizgjim për secilin, që të bëjë një zgjidhje se si dëshiron të vdesë."

Përshtatur nga këta burime:

<http://www.aljazeera.com/news/2015/04/interview-played-cello-baghdad-bombsite-150429191916834.html>

<http://www.npr.org/2015/06/08/412284066/amid-violence-in-baghdad-a-musician-creates-a-one-man-vigil>

Foto:

<http://www.gettyimages.in/detail/news-photo/karim-wasfi-former-director-for-the-iraqi-national-symphony-news-photo/473477718>

Aktivistët e paqes – Lejma Gbovi (Leymah Gbowee)



KUSH ËSHTË LEJMA GBOVI?

Lejma Gbovi e pranoi çmimin Nobel të paqes në vitin 2011 për punën e saj në drejtimin e lëvizjeve paqesore të grave, të cilat kanë sjellë përfundim të luftës së dytë qytetare në Liberi në vitin 2003. Lufta civile është luftë ndërmjet grupeve të ndryshme të njerëzve brenda shtetit të njëjtë.

Lejma ishte e lindur në Liberinë qendrore në vitin 1972. Ajo jetonte me prindërit dhe motrat e saj në Monrovi, kryeqytetin e Libirisë, kur filloi lufta e parë civile në

Liberi. Ajo qartë i mban mend ditët, kur filloi lufta e parë civile në Liberi. “Një ditë korriku në mëngjes, kur ishte 17 vjeçare dhe shkoja në universitet për ta realizuar ëndrrën time, papritmas u dëgjuan të shtëna.”

ÇKA KA BËRË LEJMA GBOVI?

Duke e parë ndikimin e luftës në Liberi, ajo vendosi të trajnohet si këshilltare për mjekim nga traumat, për trajtimin e ish fëmijëve ushtarë. Këshilltari për mjekimin e traumave iu ndihmon njerëzve, të cilët kanë pësuar në luftë, në situata të dhunshëm ose ekstreme, të rimëkëmben nga përvoja e përjetuar.

Ajo i organizoi gratë tjera të krishtere, që të ndërmarrin veprime për paqe. Pastaj ajo punoi me gratë muslimane, duke i bashkuar për herë të parë të dy grupet.

Lejma ishte zëdhënësi i grupit dhe i drejtoi gratë në protesta publike, që zgjatën me javë, të cilave iu bashkëngjitën mijëra njerëz. Lejma i drejtoi në protesta paqësore gratë e Libirisë me veprime masive për paqe, me çka e detyruan kryetarin Çarls Tejlor të takohet me ta dhe të pajtohet për pjesëmarrje në bisedimet formale të paqes në Gana.

Lejma është themeluese dhe presidente e Fondacionit të Paqes Gbovi (Gbowee) nga Afrika me seli në Liberi. Fondacioni i saj ofron mundësi për arsim dhe lidërsip për vajzat, gratë dhe të rinjtë në Afrikë Perëndimore.

Përshtatur nga këta burime:


<http://nobelwomensinitiative.org/meet-the-laureates/leymah-gbowee/>

http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/2011/gbowee-bio.html

Foto:

<https://www.flickr.com/photos/aktivoslo/6481869765>

Aktivistët e paqes – Mahatma Gandhi (Mahatma Gandhi)



KUSH ËSHTË MAHATMA GANDI?

Mahatma Gandhi është lindur më 2 tetor të vitit 1869 në një familje të pasur. Babai i tij, i cili ishte udhëheqës në bashkësinë e tyre dëshironte që Gandhi të bëhet avokat, ashtu që e dërgoi në studime në Londër në moshën 19 vjeçare.

Pa tre viteve, ai u kthye në Indi, ku u orvat ta hap zyrën e vetë të avokaturës, por nuk pati sukses. Ai vendosi të punësohet në një zyrë tjetër të avokaturës dhe u vendos në Afrikën e Jugut. Përderisa Gandhi ishte në Afrikën e Jugut i përjetoi paragjykimet racore kundër hindusve. Për 20 vite ia e kundërshtoi legjislacionin diskriminues kundër hindusve. Ky diskriminim e shpiu Gandin të fillojë punën dhe pasionin për të drejtat civile.

ÇKA KA BËRË MAHATMA GANDHI?

Në vitin 1914, kur Gandhi u kthye në Indi ishte i përcaktuar të ndihmojë në luftën për pavarësi të Indisë nga kundër Mbretëria e Britanisë. Ai u bë lider i Kongresit Kombëtar të Indisë dhe synonte t'iu ndihmojë të bujqve të varfër dhe punëtorëve të protestojnë kundër tatimit dhe diskriminimit (trajtimit të grupeve të ndryshme të njerëzve në mënyrë të ndryshme). Qëllimet tjera të tij përfshinin zvogëlimin e varfërisë, mbarimin e sistemit të kastave (sistem hindu për ndarje të njerëzve, ku disa janë më të rëndësishëm dhe mund të kryejnë punë më të mira sesa të tjerët) dhe barazinë mes grave dhe burrave. Për ta zhvilluar këtë fushatë Gandhi organizoi *veprime të mosnështrimit qytetar*. Këta veprime përfshinin grupe të mëdha të njerëzve, duke refuzuar punën, uljen në rrugë dhe bojkotin e gjyqeve. Nëse të gjitha këta veprime do të bëheshin në të njëjtën kohë, ato do të kishin fuqi ta bënin që shteti për njëherë të dorëzohet.

Meqenëse këta protesta konsideroheshin të paligjshme, Gandhi u burgos disa herë për shkak të organizimit të tyre. Ai derisa ishte në burg ai agjëronte (nuk hante). Përfundimisht Qeveria e Britanisë e liroi nga burgu në vitin 1931. Banorët e Indisë e donin Gandin, për shkak se ai luftonte për të drejtat e tyre qytetare, andaj pushtetarët britanikë ishin të brengosur nga ajo që mund të ndodhte, nëse e lënë të vdesë në burg.

Njëri ndër protestat e tij të famshëm dhe të suksesshëm ishte *Marshi i Kripës*, kur britanikët vënë tatim për kripën, Gandhi vendosi të shkojë në det (241 milje më larg për ta prodhuar kripën e vetë. Në këtë marsh ai u shoqërua nga mijëra qytetarë të Indisë.

SI E BËRI DALLIMIN

Gjatë jetës së tij Gandhi ishte i përkushtuar në jetë modeste. Edhe pse ai shpenzoi shumë kohë duke protestuar, ai gjithnjë e inkurajonte protestën e padhunshme. Ai ka ngel një inspirim i madh për shumë aktivistë tjerë të paqes anekënd botës.

Përshtatur nga këto burime:

http://www.ducksters.com/biography/mohandas_gandhi.php

<http://www.biography.com/people/mahatma-gandhi-9305898#fight-for-indian-liberation>

<https://www.youtube.com/watch?v=GWhCniD9Vkl>

Foto:

Aktivistët e paqes – Malala Jusafzai (Malala Yousafzai)



KUSH ËSHTË MALALA JUSAFZAI?

Si vajzë e re, Malala Jusafzai i mposhti talibanët në Pakistan dhe kërkoi, që femrave t'iu lejohet të ndjekin shkollimin. Në vitin 2012 ajo u qëllua në kokë me pistoletë nga një taliban, mirëpo i mbijetoi sulmit.

Malala Jusafzai u lind në 12 korrik të vitit 1997 në Mingora, Pakistan. Si fëmijë ajo u bë mbrojtëse e arsimit të femrave. Për këtë arsye talibanët e kërcënonin me vdekje. Në tetor të vitit 2012, një taliban e qëlloi me

pistoletë, derisa kthehej në shtëpi nga shkolla. Ajo i mbijetoi sulmit dhe vazhdoi të flasë lidhur me rëndësinë e arsimit. Në vitin 2014 ajo u emërua dhe e fitoi çmimin Nobel për paqe, duke u bërë personi më i ri, që e fitoi këtë çmim.

ÇKA KA BËRË MALALA JUSAFZAI?

Në vitin 2009, Malala filloi të postojë blogje për BBC-në në lidhje me jetën nën kërcënimet e talibanëve, të cilët ua ndalonin arsimin. Me një platformë publike në rritje, Malala vazhdoi të flasë në lidhje me të drejtën e saj dhe të drejtën e të gjitha grave për arsimim.

Më 9 tetor të vitit 2012, rrugës për në shtëpi një person hipi në autobusin, në të cilin udhëtonte Malala dhe e qëlloi në kokë. Plaga e la pasoja të rënda Malalës. Ajo u transferua në spitalin ushtarak në Peshavar e më vonë u transferua në spital në Birmingham të Anglisë.

Ndonëse iu desh t'i bëhen disa operacione, përfshirë edhe riparimin e nervit të fytyrës, për ta rregulluar faqen e majtë të fytyrës, prapëseprapë ajo nuk kishte pësuar dëme të mëdha në tru. Në mars të vitit 2013 ia doli të shkojë në shkollë në Birmingham.

Përballë kërcënimeve të talibanëve, Malala ngel një mbrojtëse e paepur për fuqinë e arsimit. Në tetor të vitit 2014 Jusafzai e pranoi çmimin Nobel për paqe, së bashku me aktivitetin për të drejtat e fëmijëve hindus Kailash Satjarthi. Në moshën 17 vjeçare ajo u bë personi më i ri, që e pranoi çmimin Nobel për paqe.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-mun e përshkroi Malalan si mbrojtëse të guximshme dhe të spikatur të paqes, e cila përmes aktit të thjeshtë për shkuarje në shkollë u bë arsimtare globale.”

Përshtatur nga këto burime:

<http://www.bbc.co.uk/news/world-asia-23241937>

<http://www.biography.com/people/malala-yousafzai-21362253>

Foto:

https://www.flickr.com/photos/un_photo/15528368235

Aktivistët e paqes - Nelson Mandela



KUSH ËSHTË NELSON MANDELA?

Nelson Mandela ka qenë kryetari i parë i Afrikës Jugore. Ai u lind në vitin 1918. Babai ishte udhëheqës i popullatës Tembu, madje familja e tij ishte e lidhur me familjen mbretërore Tembu.

Nelsoni ishte fëmijë i mençur. Ai shkoi në një shkollë misionare para se të shkojë në koxh në Universitetin Fort Hare, ku studio drejtësinë. Në vitin 1939 Nelson e braktisi Universitetin, për shkak se studentët protestonin për mënyrën sesi menaxhoheshin gjërat. Ai shkoi në Johannesburg dhe u bë jurist në vitin 1942.

Nelson Mandela iu bashkëngjiti Kongresit Kombëtar Afrikan (ANC) në vitin 1944. Qëllimi ishte, që studentët e zinj të kenë të drejta të barabarta me studentët e bardhë.

RRETH AFRIKËS JUGORE

Shumica e popullatës në Afrikën Jugore ishin të zinj. Në vitin 1815 u bë pjesë e Mbretërisë Britanike. Qeveria plotësisht përbëhej nga të bardhët. Popullata zezake kishte pak kontroll në mënyrën e menaxhimit të qeverisë, madje shumica ishin të varfër dhe punonin si shërbëtorë në ferma, fabrika dhe miniera të arit.

Në vitin 1948 qeveria miratoi ligje të reja për t'i mbajtur të ndarë të bardhët nga të zinjët. Këta ligje të reja u quajtën “**apartheid**”.

ÇKA KA BËRË NELSON MANDELA?

Mandela kshihte dëgjuar për Mahatma Gandin dhe protestat e tija paqësore në Indi. Ai dëshironte të çlirohet nga aparteid pa luftë. Në vitin 1956 Mandela u arrestua së bashku me 155 persona tjerë dhe u dënua me 5 vjet burgim për shkak të fjalimeve të mbajtura. Në vitin 1962 u arrestua përsëri dhe u akuzua për komplot për rrëzim të qeverisë.. Mandela u dënua me burg të përjetshëm, por nuk u dorëzua.

Në vitin 1988 qeveria filloi të ndryshohet, ndërsa bota kërkonte çlirimin e Nelson Mandelas. Ai u çlirua nga burgu në vitin 1990 nga presidenti i ri, FV de Klerk, me çka të dy palët u pajtuan t'i ndërpresin përleshjet.

Në vitin 1991 ai u bë lideri i ANC-së dhe doli në zgjedhjet e vitit 1994. Për herë të parë të gjithë të bardhët, kishin të drejtë të votonin. Në vitin 1994 Nelson Mandela u bë kryetari i parë më ngjyrë i Afrikës Jugore dhe hero i njerëzve anekënd botës. Puna e tij e mundimshme dhe përkushtimi i mundësuan t'ia del në luftën për të drejtat e secilit dhe t'i mundësojë popullit afrikan të jetojë në paqe.

Përshtatur nga këto burime:

http://www.bbc.co.uk/schools/primaryhistory/famouspeople/nelson_mandela/

<http://www.timeforkids.com/news/nelson-mandela-1918-2013/97361>

Foto:

<https://www.flickr.com/photos/ilopictures/9131421781/>

Shtojca 4

UEB FAQE TJERA PËR HULUMTIM TË AKTIVISTËVË PAQESOR NGA NXËNËSIT:

Karim Uasfi (*përfshirë në Shtojcën 2*):

- <https://www.youtube.com/watch?v=3tyDtGAGoqI>
- <http://www.aljazeera.com/news/2015/04/interview-played-cello-baghdad-bombsite-150429191916834.html>
- <http://www.bbc.co.uk/programmes/p02q76y0>
- TedX Baghdad (arabisht): <https://www.youtube.com/watch?v=aOJGCW9DY8c>
- <https://www.facebook.com/pages/Peace-Through-Art-Foundation-%D9%85%D8%A4%D8%B3%D8%B3%D8%A9-%D8%A7%D9%84%D9%81%D9%86-%D9%84%D9%84%D8%B3%D9%84%D8%A7%D9%85/1569083450009852>

Lejma Gbovi (*përfshirë në Shtojcën 2*):

- <http://nobelwomensinitiative.org/meet-the-laureates/leymah-gbowee/>
- http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/2011/gbowee-bio.html
- http://www.ted.com/talks/leymah_gbowee_unlock_the_intelligence_passion_greatness_of_girls?language=en

Mahatma Gandhi (*përfshirë në Shtojcën 2*):

- http://www.ducksters.com/biography/mohandas_gandhi.php
- <https://www.youtube.com/watch?v=GWhCniD9Vkl>

Malala Jusafzai (*përfshirë në Shtojcën 2*):

- <http://www.bbc.co.uk/news/world-asia-23241937>
- http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/2014/yousafzai-facts.html

Nelson Mandela (*përfshirë në Shtojcën 2*):

- http://www.bbc.co.uk/schools/primaryhistory/famouspeople/nelson_mandela/
- <http://www.timeforkids.com/news/nelson-mandela-1918-2013/97361>

Aktivistë tjerë paqësorë për hulumtim

Kailash Satjarthi (Kailash Satyarthi):

- <http://www.theguardian.com/world/2014/oct/10/nobel-peace-prize-winner-kailash-satyarthi>
- http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/2014/satyarthi-facts.html

Kiko Mendes (Chico Mendes):

- <http://news.bbc.co.uk/1/hi/7795175.stm>
- <http://www.theguardian.com/world/2013/dec/20/brazil-salutes-chico-mendes-25-years-after-murder>

Xhavid Abdelmuneim (Javid Abdelmoneim):

- <http://www.msf.org.uk/node/27891>

Xhejn Adams (Jane Addams):

- <http://www.scholastic.com/browse/article.jsp?id=4948>

Helen Keler (Helen Keller):

- <http://mrnussbaum.com/helen-keller/>
- <http://www.biography.com/people/helen-keller-9361967>

Martin Luter King Junior (Martin Luther King Jr.):

- http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/1964/king-bio.html
- http://www.bbc.co.uk/history/people/martin_luther_king.shtml
- <http://www.history.com/topics/black-history/martin-luther-king-jr>

Papa Francisi:

- <http://www.newyorker.com/magazine/2013/12/23/who-am-i-to-judge>

Helmetat e bardha në Siri:

- <http://www.bbc.co.uk/news/magazine-29666350>
- <http://wagingnonviolence.org/2014/09/syrias-white-helmets-dangerous-job-world/>

Shtojca 5

AKTIVITETET SHITESË:

Krijoni në klasë “Kontrata e paqes”:

- Punoni së bashku me nxënësit, për të krijuar metoda për ruajtjen e paqes në klasë. Shkruajeni ose shtypeni kontratën në një fletë letre dhe kërkoni nga klasa ta nënshkruajë atë.

Sfida e mirësisë së madhe:

- Merrni pjesë në “Java për sfidim të mirësisë e madhe” në shkollë, duke e shkarkuar (nga interneti) Nenin e fletës së mirësisë dhe pakon me vegla.
- Merrni pjesë individualisht: <http://greatkindnesschallenge.org/event.html>
- Regjistrojeni shkollën tuaj dhe përkushtohuni ta bëni kampin tuaj vend më të këndshëm: <http://greatkindnesschallenge.org/School/event.html>